



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPERISË

Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • Tel: ++355 4 222230; 222750; 235568
• Fax: ++355 4 223558 • Website www.bankofalbania.org • E-mail: public@bankofalbania.org

Tiranë, më 19.03.2004

DEKLARATË PËR SHTYP

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË SHQIPTARE PËR VITIN 2003

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për vitin 2003 rezultoi me tepriçë 99.6 milionë dollarë. Flukset hyrëse të kapitalit nuk kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar plotësisht nivelin e deficitit korent.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund t'i përgjithësojmë në:

- Deficiti korent gjatë vitit 2003, në krahasim me një vit më parë, është zvogëluar si në vlerë absolute ashtu edhe në për qindje ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (PBB).
- Importi i mallrave është rritur me 20 për qind ndërsa eksporti me 35 për qind në krahasim me vitin 2002. Mbulimi i importeve nga eksportet ishte 25 për qind, gjë që përbën një përmirësim të lehtë në krahasim me vitin e kaluar.
- Deficiti korent është financuar në masën 88 për qind nga hyrjet neto të kapitalit të cilat u vlerësuan 359 milionë dollarë.
- Në llogarinë korente, bilanci negativ në tregtinë e mallrave dhe të shërbimeve (1 miliardë e 420 milionë dollarë) u balancua pjesërisht nga bilanci pozitiv i të ardhurave dhe transfertave korente (1 miliardë e 12 milionë dollarë). Në këto të fundit, pjesën më të madhe e përbëjnë prurjet nga emigrantët, të cilat këtë vit u vlerësuan rreth **780 milionë dollarë**.
- Shkalla e hapjes ekonomike të Shqipërisë¹ vlerësohet në nivelin 61 për qind ose 1 pikë përqindje më e vogël se në vitin 2002, dhe lë për të dëshiruar në raport me vendet e rajonit.
- Rritja e detyrimeve financiare ndaj jorezidentëve është shkaktuar kryesisht prej investimeve të huaja direkte, të cilat u vlerësuan 178 milionë dollarë dhe prej huamarrjes nga jashtë, e cila arriti në **144 milionë dollarë**.
- Rritja e pretendimeve të vendit ndaj jo-rezidentëve (126 milionë dollarë) ka ardhur si pasojë e rritjes së depozitave, investimeve të portofolit, valutës në pronësi të rezidentëve dhe investimeve të tjera.
- Rezervat valutore në fund të vitit kapën nivelin 1 miliardë e 25 milionë dollarë. Ky nivel është i mjaftueshëm për të mbuluar 4.7 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.
- Gjatë vitit 2003 dollari amerikan është nënçmuar ndjeshëm si ndaj monedhës europiane, ashtu edhe ndaj lekut. Efekti i zhvlerësimit të dollarit duhet të merret parasysh sidomos në transaksionet

¹ E llogaritur si raport i vëllimit tregtar në mallra dhe shërbime ndaj PBB-së.

e kryera në monedha të tjera (euro). Deficiti tregtar i matur në euro gjatë vitit 2003 rezulton 3.4 për qind më i ulët sesa ai i vitit të kaluar dhe jo 16 për qind më i lartë, siç rezulton nga shifrat në dollarë amerikanë.

I. Llogaria korrente

Transaksionet korrente vlerësohen në rreth 5 miliardë dollarë ose 28 për qind më të larta se në vitin paraardhës. Përveç tregtisë së jashtme në mallra dhe shërbime, në këtë rritje kanë kontribuar dhe transfertat korrente. Deficiti korrent vlerësohet në rreth 407 milionë dollarë ose 6.7 për qind e PBB për vitin 2003 (zvogëlim vjetor me 2 pikë përqindje ndaj vitit 2002). Përmirësimi i pozicionit të deficitit korrent erdhi si rezultat i rritjes së transfertave pashpërbim dhe të të ardhurave neto nga investimet e rezervës si dhe luhatjet e vërejtura në këmbimin e dollarit kundrejt euros dhe lekut. Ndërkohë që, deficiti i tregtisë në mallra dhe shërbime ka ardhur në rritje.

I. 1. Tregtia e jashtme.

Vëllimi i tregtisë së jashtme, importe plus eksporte, për vitin 2003 ishte 2.2 miliardë dollarë, duke përfaqësuar rreth 45 për qind të totalit të transaksioneve korrente. Importet shënuan afërsisht vlerën **1.8 miliardë dollarë** dhe përbëheshin kryesisht nga mallrat që përdoren në investime, lëndë të para për përpunim aktiv si edhe mallrat e konsumit. Eksportet u rritën me 35 për qind në krahasim me vitin e kaluar duke arritur në **447 milionë dollarë**.

Deficiti tregtar për vitin 2003 arriti në rreth **1.3 miliardë dollarë** dhe vlerësohet **16 për qind më i lartë sesa ai i vitit paraardhës**. Në vlera absolute, rritja e importeve, nga viti në vit, është shoqëruar me rritje modeste të eksporteve. Edhe pse gjatë vitit 2003, rritja nga viti në vit e eksporteve ka qenë më premtuese sesa ajo e viteve të tjera (117 milionë dollarë), vëllimi total i eksporteve është aq i vogël sa që shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet nuk e kalon masën 25 për qind. Zhvillimi jo i kënaqshëm i eksporteve, gjatë viteve të fundit është i lidhur me disa arsye. Arsyeja kryesore është shkalla e ulët e konkurrencialitetit të prodhimit të brendshëm në tregjet ndërkombëtare. Ky tipar ka bërë që eksportuesit shqiptarë të mos kenë mundësi të shfrytëzojnë aq sa duhet avantazhet e rrjedhura nga marrëveshjet e tregtisë së lirë në rajon. Kërkesa e huaj, dhe sidomos ajo e vendeve të Bashkimit Europian për eksporte shqiptare, falë zhvillimit të ngadaltë ekonomik botëror, ka mbetur të paktën në të njëjtat nivele si në dy-tre vitet e mëparshme. Mosinkurajimi i prodhimit vendas, ka rezultuar jo vetëm në vazhdimësinë e importeve të mallrave të konsumit, por edhe në një bllokim pothuajse të përgjithshëm të eksporteve të kësaj natyre.

I. 2. Zhvillimet në zërat e tjerë të llogarisë korrente.

Viti 2003 u karakterizua nga një deficit i lartë në tregtinë e shërbimeve. Eksporti neto i shërbimeve për vitin 2003 u vlerësua në **-82.7 milionë dollarë**, duke qenë mjaft më i lartë se ai prej -5.2 milionë dollarësh i regjistruar në fund të vitit 2002. Deficiti i vitit 2003, paraqet një kthesë në llogarinë e shërbimeve e cila gjatë viteve 1999-2001 ka regjistruar suficite të vazhdueshme.

Eksporti i shërbimeve vazhdon të dominohet nga **aktiviteti i turizmit**. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, **turizmi ka gjeneruar rreth 522 milionë dollarë flukse të ardhurash në shërbime ose rreth 17 për qind më shume se eksporti i mallrave**, si pasojë e rritjes si në numrin e turistëve ashtu edhe në shpenzimet ditore të tyre.

Ndërkohë, shqiptarët kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 489 milionë dollarë ose sa 63 për qind të totalit të dërgesave nga emigrantët. Shpenzimet për turizmin janë rritur më shpejt se sa të ardhurat në krahasim me vitin e kaluar. Në fund të vitit bilanci pozitiv i kësaj kategorie vlerësohej 33 milionë dollarë nga 121.4 në vitin 2002.

Shërbimet e transportit dhe ato të sigurimit ndjekin zhvillimet në aktivitetin tregtar të mallrave. Rritja e vëllimit të importit ka shkaktuar rritjen e importit të shërbimeve të këtyre kategorive. Njëkohësisht, pjesëmarrja gjithnjë e më e madhe e shoqërive rezidente të transpedicionit, që ofrojnë shërbime në tregtinë e jashtme, ka rritur ndjeshëm të ardhurat e kësaj kategorie. Në fund të vitit deficitet në shërbime transporti dhe siguri vlerësohen në rënie ndaj vitit të kaluar, respektivisht me 20 dhe 63 për qind.

Kategoria 'shërbime të tjera' ka regjistruar një deficit prej 10 milionë dollarësh, duke qenë larg suficitit prej 30 milionë dollarësh të regjistruar në fund të vitit 2002. Deficiti i sivjetshëm është shkaktuar kryesisht si pasojë e rritjes së shpenzimeve për asistencën teknike, që vendi ynë ka vazhduar të sigurojë nga jashtë. Këto shpenzime gjatë vitit 2003 kanë kapur shifrën 44 milionë dollarë.

Bilanci pozitiv i të ardhurave, në fund të vitit, **vlerësohet rreth 170 milionë dollarë**. Ky suficit i dedikohet të ardhurave nga puna e punëtorëve sezonalë dhe atyre kufitarë, dhe interesave të akumuluar nga investimi i rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente si dhe atyre të përfutuara nga investimet e sistemit tonë bankar në formën e investimeve të portofolit.

Transfertat korente, ashtu si edhe gjatë viteve të kaluara, kanë marrë formë prej prurjeve nga emigrantët. Këto të fundit përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të deficitit në tregti mallrash dhe shërbimesh dhe gjatë vitit 2003 janë vlerësuar në nivelin 778 milionë dollarë duke qenë 23 për qind më të larta se ato të vitit të kaluar. Megjithatë, duke pasur parasysh monedhat në të cilat kryhen këto transfertat, mund të themi se edhe në këtë zë, efekti i kursit të këmbimit është i ndjeshëm.

II. Llogaria kapitale dhe financiare.

Flukset neto hyrëse të kapitaleve, gjatë vitit 2003, regjistruan **rreth 359 milionë dollarë** dhe vlerësohen **9.4 për qind më të larta ndaj vitit 2002**. Suficiti në llogarinë kapitale dhe financiare flet për një nivel të ulët të kursimeve të brendshme krahasuar me vlerën e investimeve dhe që Shqipëria është një importues neto. Flukset hyrëse të kapitalit financuan deficitin korent në masën 88 për qind. Transfertat kapitale shënojnë 157 milionë dollarë, ose 29 për qind më të mëdha se ato të vitit paraardhës dhe llogaria financiare u mbyll me një bilanc pozitiv prej 202 milionë dollarësh. Ky import kapitalesh, i realizuar kryesisht prej thithjes së investimeve të huaja direkte dhe prej lëvrimeve të kredive afatgjata dhe të zbutura nga jashtë, ka shkaktuar rritjen e detyrimeve financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës me 328 milionë dollarë. Kjo rritje vlerësohet 22 për qind më e lartë se ajo e një viti më parë.

Investimet e huaja direkte për vitin 2003 vlerësohen në nivelin 178 milionë dollarë ose 32 për qind më të larta se ato të vitit 2002. Këto flukse kapitali janë shndërruar në një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare duke zënë rreth 54 përqind të bilancit pozitiv të llogarisë financiare.

Faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare gjatë vitit 2003 kanë qenë lëvrimet e kredive afatgjata dhe të atyre të buta nga jashtë, të cilat **kanë shtuar borxhin e jashtëm të Shqipërisë me 155.5 milionë dollarë**. Në këtë borxh përfshihet dhe përdorimi i huave dhe kredive në Fond prej 11 milionë dollarësh. Pjesa dërrmuese e këtyre huave është përdorur nga qeveria shqiptare. Financuesi kryesor i qeverisë, ashtu sikurse edhe më parë, mbetet Banka Botërore nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA). Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit, gjatë vitit regjistruan rreth 37 milionë dollarë.

Detyrimet në formën e depozitave të jorezidentëve në sistemin tonë bankar për vitin 2003 janë rritur me 19 milionë dollarë, rritje kjo pothuajse 2.2 herë më e madhe se ajo e vitit të kaluar. Kjo rritje është pasojë edhe e një efekti të theksuar të kursit të këmbimit (12 milionë dollarë) duke patur parasysh që 80 për qind e këtyre depozitave është në euro, 15 për qind në usd dhe 5 për qind në monedha të tjera. Detyrimet në formën e kredisë tregtare gjatë vitit 2003 u rritën me 11 milionë dollarë ose 64 përqind më shumë se në vitin paraardhës. Kjo rritje është reflektuar edhe në rritjen e importit të mallrave për këtë periudhë.

Pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës, gjatë vitit 2003, janë rritur me 126 milionë dollarë amerikanë, ose rreth dy herë më shumë se gjatë vitit 2002. Peshën më të madhe në këtë rritje e mban rritja në mjetet valutore në cash. Ndryshe nga viti i kaluar kur ato patën rënie, zotërimet në mjete valutore të publikut këtë vit janë rritur me 35 milionë dollarë.

Edhe në këtë pikë, duhet përmendur efekti i kursit të këmbimit, pasi dihet që nga mjetet valutore të zotëruara nga sistemi bankar në vend, vetëm 28 përqind e tyre janë në dollarë, ndërkohë që pjesa tjetër është në euro (66 për qind), stërlina angleze (4 për qind) dhe franga zviceriane (2 për qind).

Në të njëjtën masë si mjetet valutore cash, janë rritur gjatë vitit edhe depozitat e sistemit bankar jashtë. Në përbërjen e tyre në fund të vitit 2003, depozitat në dollarë amerikanë zinin 52 për qind dhe ato në euro 46 për qind. Stoku i mjeteve financiare në formën e investimeve të portofolit kapi shumën 142 milionë dollarë, duke shënuar një rritje vjetore prej 26 miliona dollarësh.

Flukset hyrëse në mjete valutore në formën e kapitaleve financiare (kryesisht disbursimet e kredive të huaja dhe përdorimi i kredive) u reflektuan në rritjen e rezervave valutore të autoritetit monetar me rreth 99 milionë dollarë për vitin 2003. Niveli rezervave valutore bruto, në fund të vitit, u vlerësua 1025.6 milionë dollarë, i mjaftueshëm për të përballuar 4.7 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Bilanci i Pagesave

në milionë dollarë amerikanë

	Viti 2002	3m-I 2003	3m-II 2003	3m-III 2003	3m-IV 2003	Viti 2003
Llogaria Korrente	-420.8	-32.3	-120.6	-108.4	-145.5	-406.7
Eksporti i mallrave	330.2	108.5	113.7	102.0	122.9	447.2
Importi i mallrave	-1485.4	-394.0	-453.8	-434.0	-501.6	-1783.5
Bilanci Tregtar	-1155.1	-285.5	-340.1	-332.0	-378.7	-1336.3
Shërbimet: Kredi	585.0	129.0	179.1	213.5	198.0	719.7
Shërbimet: Debi	-590.3	-125.0	-194.3	-246.5	-236.6	-802.4
Të Ardhurat: Kredi	146.9	44.0	49.2	56.8	44.8	194.8
Të Ardhurat: Debi	-20.6	-5.1	-6.9	-4.9	-7.6	-24.4
Transferta Private Pashpërblim	575.0	198.1	177.0	189.7	216.9	781.7
Transferta Shtetërore Pashpërblim	38.2	12.1	15.4	15.0	17.8	60.3
Llogaria Kapitale	121.2	31.0	36.5	45.7	43.8	157.0
Llogaria Financiare	206.9	55.5	56.0	24.4	66.1	202.0
Investime Direkte	135.0	38.0	48.3	42.0	49.8	178.0
Investime Portofoli	-36.8	-12.1	5.4	-14.2	-1.6	-22.5
Kapitale të Tjera*	103.4	24.1	2.3	-9.0	17.9	35.3
Gabime dhe Haresa Neto	121.3	2.8	32.3	55.6	56.7	147.4
Bilanci i Përgjithshëm	28.6	57.0	4.2	17.2	21.2	99.6
Rezervat dhe Zëra të Lidhur me to.						
Mjetet e Rezervës	-28.6	-57.0	-4.2	-17.2	-21.2	-99.6
Përdorim Huash e Kredish nga FMN	5.3	5.5	0.0	5.6	0.0	11.1
Për t'u Mbajtur në Vëmendje						
Ndeshimi Total në Rezerva	-109.9	-61.0	-32.7	-19.7	-62.2	-175.6
nga të cilat: ndeshim nga kursi i këmbimit	65.0	12.5	22.1	12.3	40.1	87.0

*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN